



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ARTA GJ. PJETËRNIKAJ
ADRESA NR.9, DERVISH HATIXHE,
NR.64, NR.1, NR.1
TEL: 0672029096

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 1836

Nr. koleksioni: 809

Tirane më 12/05/2022

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë



A2022052690086712242



A2022052690086712242

KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI

(TË SHOQËRISË, "JL TRADE INTERNATIONAL GMBH ALBANIA SH.P.K)

Sot, më datë 12/05/2022, para meje Notere ARTA GJ. PJETËRNIKAJ, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.9, DERVISH HATIXHE, NR.64, NR.1, NR.1, u paraqit personalisht:

SHITES: **Ardian Gojani**, atësia Frrok, amësia Dile, shtetas Shqiptar, lindur në Laç, Krujë dhe banues në Kurbin, me adresë Laç, Kurbin; Laç; 0000; Kurbin, lindur më 07/04/1969, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me pasaporte nr. BF7347290 dhe nr. personal G90407097U.

BLERES: **Nikoll Gojani**, atësia Frrok, amësia Dile, shtetas Gjerman, lindur në Kryezi, Puke dhe banues në me adrese 69514 Laudenbach, Schillerstrase 21B, lindur më 25/05/1961, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtësi i nr prsona shqiptetar G10525123H për identitetin e të cilit u garantova me psaporte nr. C8YR7JV84.

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë " **JL TRADE INTERNATIONAL GMBH ALBANIA** " **Sh.p.k.**, sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

PËRSHKRIMI I OBJEKTIT

"Pala Shitese e mesiperme deklaron se eshte ortak i shoqerise " **JL TRADE INTERNATIONAL GMBH ALBANIA** " shpk, regjistruar me L8229020V, me seli në adresë Rruga "G.W.Bush" Nd. 19, H3, Ap 7 Njesia Administrative Nr.2, Tirane, zoterues i nje kuote me pjesemarrje ne perqindje 40% të kapitalit te shoqerise, Kontributi ne para "40.000, 00 leke (dyzet mije leke).

Objekti i kesaj kontrate eshte shitja e 10% te kuotave te kapitalit te shoqerise " **JL TRADE INTERNATIONAL GMBH ALBANIA** " shpk. te cilat zoterohen nga z Ardian Gojani ku pas marrjes se vendimit te mbledhjes se Asamblese se Ortakeve, z. Ardian Gojani deklaron se i shet Z. Nikoll Gojani, pales Blerese, 10 % te kuotes qe ai zoteron ne shoqeri.


Pala blërese do te bëhet zoteruese e nje kuote, me pjesemarrje ne perqindje prej 10 % te kapitalit te shoqerise, Kontributi ne para "10.000, 00 leke (dhjete mije leke).

Pala shitese deklaron se i shet Z. Nikoll Gojani kuotat e kapitalit ne vleren prej 10.000,00 lekesh (dhjete mije leke).

Pala Blerese deklaron se pranon te bleje kuotat e kapitalit te specifikuara me siper dhe nuk ka asnje pretendim per kete shitje dhe pala blerese behet ortak me 10% te kuotave te kapitalit te shoqerise " **JL TRADE INTERNATIONAL GMBH ALBANIA** " **sh.p.k.**

Pala Blerese, me regjistrimin e vendimeve te asamblese se ortakeve per transferimin e kuotave ne QKB dhe depozitimimin e kontrates se shitjes se kuotave te kapitalit njihet pronare ekskluzive me 10 % te kapitalit te shoqerise:

- Z. Nikoll Gojani behet ortak me 10% te kuotave te kapitalit te shoqerise, zoterues i nje kuote ne vleren prej 10.000 leke, ndersa administrator i shoqerise do te jete Z. Nikoll Gojani



A2022052690086712242

Palët bien dakord që do të zbatojnë të gjitha dispozitat ligjore perkatëse për regjistrimin e këtij akti noterial në të gjitha institucionet perkatëse.

ÇMIMI I SHITJES DHE MËNYRA E PAGESËS

Çmimi i shitjes së kuotës së kapitalit të shoqërisë që Blerësi u detyrohet Shitësve për blerjen e saj është në vlerë monetare 10 000 Leke (dhjete mijë) e cila është likuiduar nepermjet paleve.

Palët deklarojnë me përgjegjësi ligjore se nga ana e Blerësit është likuiduar totalisht vlera monetare e sipërcituar prej 10'000 Leke (dhjete mijë), e cila përbën vlerën e plotë të pjesës së kuotës së shitësit, për të cilën palët kanë rënë dakord.

BAZA LIGJORE

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij;

Ligji 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";

Ligji nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".

ANEKSET E KONTRATËS Anekse të Kontratës;

Kësaj kontrate i bashkëlidhen si pjesë përbërëse dhe të pandarë këto dokumente që do të quhen

- Vendimet e Asamblesë së Ortakëve

- Ekstrakt i Regjistrimit Tregtar për Shoqërinë "JL TRADE INTERNATIONAL GMBH ALBANIA" Sh.p.k.

- Informacioni i marrë nga Regjistri i Barrëve Siguruese, Tiranë;

- Dokumentet e identifikimit të palëve kontraktuese.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres. Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve nepermjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

PALËT KONTRAKTUESE

SHITES

Artdian Gjoçani
Artdian

BLERES

Nikoll Bejani
Nikoll


NOTERE
ARTA GJ. PJETËRNIKAJ

REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit të Kërkimit: D-20220510115646442
Data e Rezultatit të Kërkimit: 10.05.2022
Ora e Rezultatit të Kërkimit: 11:56:46AM
Lloji i Kërkimit:
Numri i Dokumentit: D-400-599-1398
Referenca e Përdoruesit:

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KËRKIMI 0

ARDIAN FRROK GOJANI
JLTRADE INTERNATIONAL GMBH ALBANIA SH.P.K.



Ardisëta Fozen



EKSTRAKT HISTORIK I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	L82029020V	
2. Data e Regjistrimit	29/08/2018	
3. Emri i Subjektit	JLTrade International GmbH Albania	
4. Forma ligjore	SHPK	
5. Data e themelimit	27/08/2018	
6. Kohëzgjatja	Nga: 27/08/2018	
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Njesia Administrative Nr.2, Rruga "G.W.Bush", Nd.19, H 3, Ap.7	
8. Kapitali	100.000,00	
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	2,00	
9. Objekti i aktivitetit	Import - eksport artikuj të ndryshëm, hotelëri dhe turizem, etj.	
10. Administratori/ët	MICHAEL JURGEN ULLRICH	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 19/07/2019	Deri: 19/07/2024
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Administratori/ët	Ardian Gojani	
12.1 Afati i emërimit	Nga: 27/08/2018	Deri: 27/08/2023
13. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
13.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
14. Eksperti/ët Kontabël (nëse ka)	Erjon Pjetërnikaj	
14.1 Afati i emërimit	Nga: 27/08/2018	Deri:
15. Ortakët	Michael JurgenUllrich	
15.1 Vlera e kapitalit	Para: 60.000,00	Natyre:
15.2 Numri i pjesëve	1,00	
15.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	60,00	

- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)	
16. Ortakët	ArdianGojani
16.1 Vlera e kapitalit	Para: 40.000,00 Natyre:
16.2 Numri i pjesëve	1,00
16.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	40,00
- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)	
17. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	
18. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: JLTrade International GmbH Albania E-Mail: ardiangojani7@gmail.com j.ullrich@ullrichequine.com Telefon: 0696681353
19. Statusi:	Aktiv

Lista e Dokumenteve:

Statuti (nese eshte hartuar si dokument i ndryshem nga akti i themelimit)

Akti i themelimit

Mandati bankar ose vertetimi i noterit per pagesen e kapitalit ne para - (nese kapitali eshte paguar)

Dokumenti i autorizimit

Regjistrimi Fillestar: CN-919110-08-18


HISTORIKU I REGJISTRIMIT

Data e regjistrimit	Ndryshimi i te dhenave te regjistruara
17/06/2019	Numri i ceshtjes: CN-226887-06-19 (APLIKIM PER DEPOZITIM PASQYRA FINANCIARE) Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi i Pasqyrave Financiare 2018. Lista e Dokumenteve: <u>Pasqyra e pozicionit financiar.xlsx</u> <u>Vendimi i Ortakeve.pdf</u> <u>Shenimet Shpjeguese.pdf</u> <u>Pasqyra e performancës (pasqyra e të ardhurave dhe të shpenzimeve) sipas natyres.xlsx</u>
23/07/2019	Numri i ceshtjes: CN-276056-07-19 Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi i vendimit date 19.07.2019, ku eshte vendosur: Miratimi emerimit te MICHAEL JURGEN ULLRICH si administrator i shoqerise.

	<p><u>Kane ndodhur ndryshimet e meposhtme tek administratoret: eshte shtuar administratori: ("MICHAEL JURGEN ULLRICH") Nga data "19/07/2019 Ne daten "19/07/2024</u></p>
	<p><u>Lista e Dokumenteve:</u> <u>Vendim i asamblese se pergjithshme</u> <u>Mandati bankar ose vertetimi i noterit per pagesen e kapitalit ne para - (nese kapitali eshte paguar)</u></p>
21/07/2020	<p>Numri i ceshtjes: CN-551709-07-20 (APLIKIM PER DEPOZITIM PASQYRA FINANCIARE) Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi i Pasqyrave Financiare 2019.</p> <p><u>Lista e Dokumenteve:</u> <u>Vendimi i ortakeve.pdf</u> <u>Pasqyra e performancës (pasqyra e të ardhurave dhe të shpenzimeve) sipas natyres.xlsx</u> <u>Pasqyra e pozicionit financiar.xlsx</u> <u>Shenimet Shpjeguese.pdf</u></p>

Datë: 12/05/2022

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)



VENDIMI I ASAMBLESE SË ORTAKËVE

i datës 04/05/2022

Asambleja e ortakëve themelues të shoqërisë "JL Trade International GmbH Albania" Shpk, mbeshtetur në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" neni 81, dhe statutin e shoqërisë vendosi :

VENDOSI :

1. Të shes 10% të kuotave të kapitalit të shoqërisë "JL Trade International GmbH Albania" Shpk, sipas kontratës së shitjes noteriale bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Pas shitjes së kuotave të kapitalit, kapitali i shoqërisë "JL Trade International GmbH Albania" Shpk zotërohet:

Ishte: Zotërohet 60% nga ortaku Michael Jurgen Ullrich, vlera 60 000 leke, që i korrespondon 1 kuotë e vetme.

Zotërohet 40% nga ortaku Ardian Gojani, vlera 40 000 leke, që i korrespondon 1 kuotë e vetme.

Bëhet: Zotërohet 60% nga ortaku Michael Jurgen Ullrich, vlera 60 000 leke, që i korrespondon 1 kuotë e vetme.

Zotërohet 30% nga ortaku Ardian Gojani, vlera 30 000 leke, që i korrespondon 1 kuotë e vetme.

Zotërohet 10% nga ortaku Nikoll Gojani, vlera 10 000 leke, që i korrespondon 1 kuotë e vetme.

3. Vendimi të depozitohet në QKB Tiranë.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ortakët e shoqërisë :

Michael Jurgen Ullrich, zot. 60% të kapitalit

Ardian Gojani zot. 40% të kapitalit

